



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5864 Prot.

Tiranë, më 22.10. 2021

URDHËR

Nr. 412, datë 22.10. 2021

PËR  
EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË BORDIT  
TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS  
PËRFAQËSUES TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49 dhe 50 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Emërimin në detyrë të anëtarëve të Bordit të Administrimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si më poshtë:
  - a) Adriana Ristani;
  - b) Mirela Bimo;
  - c) Jorgaq Kaçani.
2. Emërimin e Z. Fatjon Dhuli si anëtar i përkohshëm deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, dhe Sportit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
Evis KUSHI

